

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues - gjyqtarin Skender Çoçaj, me procesmbajtësen Birsën Kume - sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit J. M. nga T.-Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale dhënia e ryshfetit nga neni 429 paragrafi 1 të KP-së, sipas aktakuzës së PTH në Prizren – PP/I.nr.64/2018 të datës 12.06.2018, në shqyrtimin fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarit si dhe mbrojtësit të tij av.A. Th., me datë 18.06.2018 morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

J. M., nga i ati E. dhe e ëma M., e lindur R., i lindur me *data e lindjes...* në E., me banim të përhershëm në T. Rruga ..., nuk ka shkollë të kryer, me profesion vozitës, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, babë i 5 fëmijëve, shqipëtarë- shtetas i Republikës së Shqipërisë.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 05.06.2018 rreth orës 07:55 minuta në pikën kufitare të Vërmicës, Shqipëri-Kosovë është vërtetuar se në mënyrë të drejtë për drejtë ofron personit zyrtarë përfitim pasuor në mënyrë që i njëjti të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, në atë mënyrë që gjatë kalimit të pikës doganore duke drjtuar automjetin e tipit “Ford Tranzit” me targa *numri i targës...*, në brendësinë e të cilit ka pasur edhe 3 pasagjer, në momentin kur zyrtarit policor Z. P. ia ka dorëzuar dokumentet personale të udhëtarëve dhe dokumentet e automjetit, në librezën e qarkullimit të automjetit i ka futur 10,00 euro me nr.serik NB2628868626, dhe ka kërkuar nga zyrtari policor që ta lejoj hyrjen e tij në Kosovë pa e regjistruar nga se nuk ka poseduar dokument të vlefshëm të udhëtimit dhe ka pasur ndalës që 5 vite mos të hyjë në Kosovë. Me këtë rast zyrtari policor refuzon kërkesën e tij dhe inicion rastin.

- Këso dore ka kryer veprën Dhënia e ryshfetit nga neni 429 paragrafi 1 të KP-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 7, 17 par.1, 42, 43, 45, 46 nenin 429 paragrafi 1 të KP-së, të akuzuarin e :

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në lartësi prej 400 (katërqind) euro në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 05.06.2018 deri më datën 18.06.2018, pjesën tjetër të gjobës i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë apo nuk mundet ta paguaj, dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës do ti caktohet një ditë burgim.

Në pajtim me nenin 62 lidhur me nenin 69 dhe 71 të KP të akuzuarit i shqiptohet

DËNIMI PLOTËSUES

I akuzuari J. M. dëbohet nga territori i Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve.

Të akuzuarit J. M. i konfiskohet kartmonedha në shumë prej 10 (dhjetë) euro me numër serik NB 2628868626.

Obligohet i akuzuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, si dhe 50 (pesëdhjetë) euro në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur pranë kësaj gjykate aktakuzën PP/I.nr.64/2018 të datës 12.06.2018 kundër të pandehurit J. M., për shkak të veprës penale dhënia e ryshfetit nga neni 429 paragrafi 1 të KP-së.

Prokuroria Themelore në Prizren Departamenti për krime të Rënda e ka njoftuar gjykatën për arritjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe gjykatës ia ka parashtruar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP/I.nr.64/2018 të datës 12.06.2018.

Gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 247 paragrafi 4 ka shqyrtuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ku ka dëgjuar të akuzuarin, mbrojtësin e tij si dhe prokurorin e shtetit lidhur me pretendimet e tyre sa i përket marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Sa i përket gjendjes faktike gjykata e ka vërtetuar ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e aktakuzës në kushtet dhe rrethanat ligjore të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit gjatë seancës ka deklaruar se me të akuzuarin J. M. dhe mbrojtësin e tij janë marrëveshje që të hyjnë në negociim për arritjen e marrëveshjes për pranim të fajësisë, me ç' rast janë dakorduar që i akuzuari e ka pranuar fajësinë dhe në këmbim të pranimit të fajësisë të cilën e ka bërë me shprehjen e lirë të vullnetit të tij për veprën penale të dhënies së ryshfetit ti shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 400 euro. Kjo marrëveshje ka ardhë si rezultat i pranimit të kushteveve nga të dy palët, e pasi që të akuzuarit si nga prokurori i shtetit ashtu edhe nga avokati mbrojtës sipas detyrës zyrtare i janë shpjeguar favorët dhe disfavorët e marrëveshjes dhe të njejtat i ka kuptuar dhe pranuar i akuzuari. Pasi që nuk ekzistojnë pengesat ligjore i propozon gjykatës që ta pranojë këtë marrëveshje për pranim të fajësisë dhe t ia shqiptojë dënimin ashtu si është propozuar në marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit J. M., avokati A. Th., ka deklaruar se ne e pranojmë marrveshjen e arritur të datës 12.06.2018 pranë Prokurorisë Themelore në Prizren dhe i propozojnë gjykatës që marrëveshjen e arritur ta aprovojë me të gjitha pikat e saj.

I akuzuari J. M. në tërësi është pajtuar me deklaratën nga mbrojtësi i tij.

Gjykata pas dëgjimit të pikpamjeve të prokurorit të shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, lidhur me pranimin e fajësisë, sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, konstatoi se i akuzuari J. M., e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. A. Th., i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë të pranuar edhe nga i akuzuari, dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat që parashihen me dispozitat e nenit 253 par. 1 dhe 2 të KPP-së, për hedhjen e aktakuzës.

Gjatë seancës për caktimin e dënimit, prokurori i shtetit ka deklaruar se sa i përket dënimit ka qëndruar pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Avokati A. Th., si dhe i akuzuari rreth dënimit i cili është propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ka deklaruar se qëndrojnë pranë dënimit të propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit, formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale, të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale-juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i dëgjoi deklaratat e të gjitha palëve, ka shqyrtuar dënimin e rekomanduar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjithashtu duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, rrethanat personale të të akuzuarit, në gjykim ka patur qëndrim tejet korrekt, pendimin dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPK, dhe se ky dënim, si i tillë, i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës, është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 451, paragrafi 1 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Pkr.nr.48/2018 me datë 18.06.2018

Procesmbajtësja
Birsen Kume

Kryetari i trupit gjykues
Skender Çoçaj

UDHËZIM JURIDIK: Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese ndaj këtij aktgjykimi, në afat prej 15 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.